

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit R. A nga Gj, me mbrojtësin me autorizim av. ..., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 e 6 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2057/2016, të datës 21.11.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurori Esat Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, mbi pranimin e marrëveshjes së fajësisë dhe të sanksionit penal, në prezencën e prokurorit, të akuzuarit, dhe mbrojtësit të tij më datën 20.09.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M I

I pandehuri **R.A.**nga i ati Sh, e ëma R, e lindur S, e lindur më dt. në V me vendbanim në ..i martuar ,bab i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon në hotileri, i gjendjes së mesme ekonomike ,shqiptar, shtetas i R.Kosovës, i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale .

Ë s h t ë f a j t o r

Me dt. 06.11.2016 rreth orës 11:00 h, në Gj derisa i pandehuri ka qenë duke e drejtuar automjetin e markës “..”, me tabela të regjistrimit..., ka rrezikuar trafikun publik duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke mos ja përshtatur shpejtësinë e lëvizjes automjetit të tij në mënyrë që automjetin ta ndal para çdo pengese në rrugë, e në kundërshtim me dispozitën ligjore 54 të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor të Kosovës, duke lëvizur në parkingun e Qendrës Tregtare “..”, me pjesën e parë të anës së djathtë të automjetit godet këmbësoren R. M, e cila ishte duke lëvizur në të njëjtin drejtim krahas veturës, e cila nga goditja e marr përplaset për asfalti, me ç’ rast e dëmtuara R., pëson lëndime të rënda trupore, e cila për shkak të lëndimeve të pësura fillimisht dërgohet në Qendrën Emergjente në Gj, e më pastaj ndalet në repartin e Ortopedisë për mjekim të mëtejshëm.

-me çka ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 8 e 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s.

Prandaj gjykata duke iu referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit Rifat Aliu, në bazë të neneve 4, 41, 45, 47, 62, 73 dhe 75 të KPRK-s dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-s

E G J Y K O N

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 145 (njëqind e dyzet e pesë) ditë, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 47 të KPRK-s, dënimi me burg prej 145 ditëve **ZEVENDSOHET** me dënim me gjobë në shumë prej 1500 € (njëmijë e pesëqind) euro, me pëlqimin e të pandehurit, të cilin dënim do ta paguaj pasi që aktgjykimi të bëhet i formës e prerë, në katër (4) këste të barabarta mujore në afat prej 1 viti, nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, dënimi me gjobë revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me 145 ditë burg.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 2, nën paragrafi 2,5 të KPP-s, të pandehurit i shqiptohet dënimi plotësues **NDALIMI I DREJTIMIT TË AUTOMJETIT**, në kohëzgjatje prej një viti nga data e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

Të akuzuarit i shqiptohet taksa për Kompenzimin e Viktimave të krimit në shumën prej 30 euro, konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të krimit. Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.2057/2016, të datës 21.11.2016, kundër të akuzuari, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 e 6 të KPRK-s

Në shqyrtimin fillestar më datë 20.09.2017, në të cilën seancë është aprovuar marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të mbrojtësit, të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit, e nënshkruar edhe nga i akuzuari dhe kryeprokurori i shtetit.

Meqë gjykata ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, pasi që është bindur paraprakisht se i akuzuari marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka nënshkruar, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të kryerjes së veprës penale, pranimi i të cilit është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimit të mjaftueshëm dhe në prezencën e mbrojtësit, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-s, që të pranohet marrëveshja e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj veprë penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoj se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 e 6 të KPRK-s, ashtu që i akuzuari është shpallur fajtor, dhe i shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit Esat Ademi Duke e marrë parasysh, që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore, të parapara sipas nenit 233 te KPP, për lidhjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, si dhe të gjitha rrethanat lehtësuese, që shkojnë në favor të të pandehurit, atëherë ne si prokurori mbetemi në tërësi pranë marrëveshjes të datës 15.06.2017, më numër PP.II.nr.2057/2016 e lidhur me të pandehurin për veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 e 6 të KPRK-ës. Prandaj bazuar në këtë kërkojmë nga gjykata, që ta aprovoj, marrëveshjen edhe dënimin e arritur sipas kësaj marrëveshje.

Mbrojtësi i të pandehurit avokati ...deklaroi: se sa i përket dënimin të rekomanduar në marrëveshjen në fjalë mbrojtja konsideron që një dënim i tillë është në harmoni me dispozitat ligjore dhe i propozojmë gjykatës që dënimin sipas kësaj marrëveshje dhe marveshja të aprovohet.

I pandehuri ...deklaroi: e ka mbështetur në tërësi deklaratën e mbrojtësit të tij.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sigurtë, sjellja dhe qëndrimi i tij shumë korrekt në gjykatë, se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë, pendimi i thellë i tij për këtë veprë penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do ta përsëris asnjëherë këtë veprim, e në mungesë të rrethanave rënduese, të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i propozuar edhe në marrëveshje për pranimin e fajësisë, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale së të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPPK-s.

Në seancën gjyqësore, përfaqësuesi i akuzës, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij janë marrë vesh edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që të pandehurit ...ti shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej nga 145 (njëqind e dyzet e pesë) ditë, i cili dënim do të zëvendësohet me gjobë në shumën prej 1500 € (njëmijë e pesëqind euro).

Bazuar në nenin 453 të KPPRK-s gjykata e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20.00 €, Përfaqësuesi i akuzës, i akuzuari dhe mbrojtësi me autorizim kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-s, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.1375/16, të dt: 20.09.2017

Sekretare juridik,
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE: Ky aktgjykim është i plotëfuqishëm ditën e shpalljes së aktgjykimit në pajtim me nenin 233 par.12 pika 1, dhe pika 3.të KPPRK-ës.

